



Pranimi / Dostava Prateno / Predato Received / Delivered		07 - 12 3 2023		vit and year
Organizata Org / Unit	Id Prot Id Prot Prot No	Shtypja Printed Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHK	7358	2023	114	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.623/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimin A.nr.2280/2021 të datës 10.10.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën A.n.223/2023 të datës 25.04.2018 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat kundër Vendimit me Nr.20-KA-A-2018 të datës 23.03.2018 të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.n.223/2023 të datës 25.04.2018 e parashtruar nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.20-KA-A-2018 i datës 23.03.2018 i Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Policinë e Kosovës më datë 19.10.2015 në pozitën "Shef i Sektorit të Flotës Operative", më datë 07.12.2017 ka parashtruar kërkesë për miratimin e shtesës në pagë nga data 19.10.2015 tutje tek Drejtori Departamentit për Burime Njerëzore në Policinë e Kosovës. Drejtorja e Personelit e Policisë së Kosovës më datë 26.02.2018 ankuesit i përgjigjet në kërkesën e datës 07.12.2017 duke mos aprovuar të njëjtën. Ankuesi kundër kësaj përgjigje më datë 09.03.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës. Komisioni për Ankesa të Policisë së Kosovës më datë 26.03.2018 ka nxjerr Vendim me numër të lëndës:020-KA-A-

2018 me numër protokoli 01/02-125 më të cilin ka hedhë poshtë si të jashtë afatshme ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër të lëndës:20-KA-A-2018 të datës 23.03.2018 të Komisionit për Ankesave të Policisë së Kosovës, më datë 25.04.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2266/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 30.04.2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 04.06.2018 ka nxjerr Vendim A.nr.223.2018 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi Vendimin me Nr. 20-KA-A-2018 i datës 23.03.2018 të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës, ndërsa ankuesi kundër këtij vendimi ka hapur konflikt administrativ në gjykatën kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.1578/18 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar vendimin e Këshillit dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes njoftimit të datës 10.08.2021 ka njoftuar përfaqësuesin e ankuesit që për shkak që Këshilli është jofunksional nuk ka shqyrtuar ankesën në fjalë, duke e udhëzuar që mund të ndjek procedurat tjera në gjykatën kompetente, ndërsa ankuesi ka hapur konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.2280/2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit, dhe duke e obliguar që të shqyrtoj ankesën e datës 25.04.2018 të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 2266/2018 të datës 25.04.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër të lëndës: 20-KA-A-2018 të datës 23.03.2018 të Komisionit për Ankesave të Policisë së Kosovës; Kontratë pune për kohë të caktuar/pacaktuar e datës 19.10.2015; Kërkesën për miratimin e shtesës në pagë e datës 07.12.2017; Përgjigjen e datës 26.02.2018 në kërkesën e datës 07.12.2017; Ankesën e datës 09.03.2018 e parashtruar nga ankuesi Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës; Vendimin për transfer i datës 07.05.2013; Vendimin me Nr. 07/29 i datës 31.07.2008 i Qeverisë së Kosovës; Vendimin me Nr. 02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Kosovës; Aprovimi i pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në Policinë e Kosovës i datës 05.12.2008; Lista e pozitive për shtesa në pagë për kuadro deficitare të teknologjisë informative dhe inxhinieringut në Policinë e Kosovës; Diplomën e ankuesit e datës 01.11.2010; Vendim i datës 16.01.2015; Procesverbali i Komisionit për Ankesa i datës 23.03.2018; Lista e pagave prill 2018; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës datë 17.08.2015 dhe Përgjigjen në ankesë të dërguar nga Policia e Kosovës; Aktgjykimin A.nr.1578/18 dhe Aktgjykimin A.nr.2280/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin A.nr.223/2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shpresave të lëndës konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 25.04.2018 pretendon që organi i punësimit nuk ka bërë kompensimin e shtesave në pagë për kategori të veçanta deficiatare sipas Vendimit Me Nr.07/29 të datës 31.07.2008 dhe Vendimit Nr.02/39 i datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficiatare në fushën e teknologjisë informative dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficiatare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficiatare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficiatare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficiatare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin i cili kishte qenë në fuqi në këtë periudhë, që ndërlidhet me objektin e ankesës Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji ishte përcaktuar se: "1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut". Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 kishte aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimin Nr.02/29 të datës 31.07.2008 dhe Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenit 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një



shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitive për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitive në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitive përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë i cili ka shfuqizuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, atëherë edhe pretendimet e ankuesit janë të porealizuara.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Komisioni i Ankesave i Policisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 20-KA-A-2018 të datës 23.03.2018, nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike, ngase nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit në meritat e saj por vetëm ka konstatuar se ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor andaj edhe si i tillë është shfuqizuar.

Kolegji i këshillit me rastin e vendimmarrjes mori për bazë edhe faktin se tashmë kemi në fuqi Ligjin për Zyrtarët Publik Nr.08/L-197,i cili në nenin 3 paragrafi 2 nënparagrafi 2.4,i cili parasheh se ky ligj nuk zbatohet për të punësuarit në Policinë e Kosovës, që është një elementë me rëndësi në këtë çështje kontestuese administrativo-juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda,A.nr.623/2021, datë 30/11/2023

Çlirim ZEKA

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avoka'
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

